

VENDIM
Nr.1370, datë 10.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË DHE MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIUMI, NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në Fakultetin Ekonomik, të programit të studimit të ciklit të dytë “Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në menaxhim i turizmit të qëndrueshëm.

2. Programi i studimeve i ciklit të dytë do të realizohet me 120 kredite dhe zgjatja normale e tij është dy vite.

3. Kuota e pranimeve në programin e studimit të ciklit të dytë “Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm”, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për vitin akademik 2008-2009, të jetë 60.

4. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 6/c/iv të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

5. Hapjen, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, si më poshtë vijon:

a) Në lëndën “Biologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën biologji;

b) Në lëndën “Kimi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën kimi;

c) Në lëndët “Gjuhë-letërsi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm në lëndët gjuhë-letërsi.

6. Kuota e pranimeve në programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për vitin akademik 2008-2009, të jetë si më poshtë:

- | | |
|---------------------------|-----|
| - Në lëndën biologji | 40; |
| - Në lëndën kimi | 40; |
| - Në lëndët gjuhë-letërsi | 40. |

7. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në këto dy programe studimi, në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 7/b/ii të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

8. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha